



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDËNTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 1407 Prot.

Tiranë, më 19.04 2021

Lënda: *Kërkohet heqja e materialeve propagandistike të vendosura në kundërshtim me Kodin Zgjedhor, si dhe fillimi i ndjekjes penale dhe vendosja para përgjegjësisë të funksionarëve publik për mos kryerjen e detyrave dhe për shkelje flagrante të nenit 79 e në vijim të Kodit Zgjedhor.*

STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

ORGANEVE DREJTUESE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Për dijëni:

**OSBE/ODIHR
MISIONI I LIMITUAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE**

PRANIA E OSBE-SË NË SHQIPËRI

DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI

AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

AMBASADA BRITANIKE

Tiranë

Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Ilir Meta prej ditësh është njohur me një ngjarje tepër të rëndë të ndodhur në disa qytete të vendit, si në qytetin e Gjirokastrës, Tiranës, Durrësit etj, e që ka lidhje jo vetëm me procesin zgjedhor që do të mbahet në 25 prill 2021, por që nga ana tjetër është një tregues i qartë se ndikimi politik i qeverisë ndaj strukturave të Policisë së Shtetit, Drejtorive Vendore të Policisë të këtyre qyteteve, si dhe bashkive Gjirokastrë, Tiranë, Durrës etj. është ekzistent ndaj këtyre strukturave, të cilat edhe pse janë përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe realizimin e disa detyrave të rëndësishme që lidhen me procesin zgjedhor, nuk kanë ndërmarrë masat e duhura për përmbushjen e tyre, sipas ligjit.